

Loja e numrave: Zgjidhja e çështjes së të zhdukurve 20 vite më vonë

Qershor
2022



1.

Asociacioni i Komunave
Serbe në Limbon e
Marrëveshjeve të
Papërmbyshura

2.

Loja e numrave: Zgjidhja
e çështjes së personave të
zhdukur 20 vite më vonë

3.

Një tjetër mollë sherri:
KOS në Dialogun
për Normalizimin e
marrëdhënieve

4.

Furnizimi me energji
elektrike në veri të Kosovës

5.

Privatizimi në Kosovë nga
këndvështrimi i komunitetit
Serb

6.

Liria e lëvizjes: Episoda
stiker

Titulli i hulumtimit: Loja e numrave: Zgjidhja e
çështjes së të zhdukurve 20 vite më vonë

Botues: Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
– KFOS

Për botuesin: Iniciativa e Re Sociale

Autore: Milica Radovanović

Gjuha origjinale në të cilën është hartuar analiza
është gjuha serbe.

Përkthimi dhe lektura: Trankos

Dizajn: tedel

Shtypshkronja (Tirazhi): 80

Ky publikim është hartuar në kuadër të projektit
OPEN, i implementuar nga Fondacioni i Kosovës
për Shoqëri të Hapur (KFOS), në bashkëpunim me
Iniciativën e Re Sociale. Pikëpamjet e shprehura
në këtë publikim janë të autorëve dhe nuk
përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e
KFOS-it.

Viti i publikimit: Qershor 2022

PËRMBAJTJA

Rreth Nismës Open 7

01.

HYRJE 8

02.

TË DHËNAT
STATISTIKORE 9

03.

PENGESAT NË
ZGJIDHJEN E
ÇËSHTJES SË
PERSONAVE TË
ZHDUKUR NË
KOSOVË 12

04.

IDENTIFIKIMI I
GABUAR, TRUPAT
E PANJOHUR
NË MORGUN
E PRISHTINËS
DHE MOSTRAT
REFERENTE QË NUK
PËRPUTHEN ME
KNPZH 17

05.

HETIMET JOEFIKASE
DHE NDJEKJA
PENALE PËR
ZHDUKJET ME
FORCË NË KOSOVË 20

06.

ARKIVAT (JO)
EKZISTUESE 24

07.

MANGËSITË
DHE DISPOZITAT
DISKRIMINUESE NË
KORNIZËN JURIDIKE
TË KOSOVËS
PËR ZGJIDHJEN
E ÇËSHTJES SË
PERSONAVE TË
ZHDUKUR 27

08.

PËRVOJAT E
FAMILJEVE TË
PERSONAVE TË
KIDNAPUAR DHE
TË ZHDUKUR NGA
KOMUNITETI SERB
NË KOSOVË 27

Rreth Nismës Open

“Demokracia, haptësia dhe perspektivat e komunitetit serb në Kosovë – OPEN” është nismë e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS), që ka filluar gjatë vitit 2020. Kjo nismë ka për qëllim të zhvillojë hapësirë të hapur e dinamike për diskutime brenda dhe mes komunitetit serb dhe komuniteteve të tjera si dhe me institucionet e Kosovës.

Organizatat e shoqërisë civile nga komuniteti serb në Kosovë, anëtare të nismës, merren specifikisht me analiza dhe vlerësime të ndikimit të organizatave civile e politike në zhvillimin e demokracisë, si dhe në haptësinë e komunitetit serb në Kosovë. Me këto analiza vlerësohet haptësia e institucioneve, politikave publike dhe proceseve të rëndësishme karshi komunitetit serb në Kosovë, si dhe niveli i haptësisë së komunitetit serb karshi tyre.

Këto analiza do të ndihmojnë të pasqyrohet gjendja aktuale dhe perspektivat e komunitetit serb në Kosovë, duke shërbyer njëkohësisht edhe si bazë për përfaqësimin e argumentuar të orientuar drejt vendimmarrësve, institucioneve të pushtetit lokal e qendror, si dhe bashkësisë ndërkombëtare.

Qëllimi i studimit dhe metodologjia e hulumtimit

Qëllimi i përgjithshëm i hulumtimit është që të ofrojë një pasqyrë të progresit të bërë në zgjidhjen e çështjes së personave të zhdukur në Kosovë dhe lëshimeve të bëra në zgjidhjen e kësaj çështjeje në dy dekadat e fundit, me theks të veçantë në përvojat e anëtarëve të familjeve të personave të zhdukur nga komuniteti serb. Qëllimi specifik i hulumtimit është të përcaktojë se sa mund të kontribuojë përfshirja zyrtare e çështjes së personave të zhdukur në dialogun ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës në zgjidhjen e saj.

Koha:

Hulumtimi është kryer në periudhën dhjetor 2021 - shkurt 2022.

Metodologjia dhe dizajni i hulumtimit kualitativ

Analiza e përmbajtjes, e cila përfshin akte ligjore dhe raporte të akterëve të shumtë, ndërkom-bëtarë dhe vendorë, të cilët janë përfshirë në zgjidhjen e çështjes së personave të zhdukur në Kosovë në dy dekadat e fundit, jep një pasqyrë të lëshimeve në këtë proces, që e vështirësojnë zgjidhjen e kësaj çështjeje njëzet vjet më vonë. Përmes 5 intervistave të pa strukturuara dhe

dy fokus grupeve me anëtarë të Shoqatës së Familjeve të Kidnapuar dhe të Zhdukur nga Komuniteti Serb, u mbledhën përvojat e anëtarëve të familjeve në një përpjekje dy dekadash për zbardhjen e fatit të anëtarëve të familjeve së tyre.

Intervistat dhe fokus grupet u zhvilluan midis janarit dhe shkurtit të vitit 2022.

1. Hyrje

Iniciativat për përfshirjen e çështjes së personave të zhdukur (pagjetur) në procesin e dialogut ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, i cili po zhvillohet nën kujdesin e Bashkimit Evropian në Bruksel, ekzistojnë që nga fillimi i negociatave. Megjithatë, çështja u vu zyrtarisht në agjendën e Negociatorëve vetëm në korrik të vitit 2020, me rifillimin e dialogut të Brukselit pas një stagnimi gati dyvjeçar, dhe nënshkrimit të Marrëveshjes së Uashingtonit në shtator të po atij viti, me ç'rast palët u obliguan se do t'i përshpejtojnë përpjekjet për gjetjen e lokacioneve dhe identifikimin e personave të zhdukur.

Dy muaj më vonë, në Kizhevak të Serbisë filluan gërmimet në lokacionin ku dyshohej se ekziston një varrezë masive.

Gërmimet në Kizhevak përfunduan në maj të vitit 2021, me zhvarrosjen e nëntë mbetjeve mortore të shqiptarëve të Kosovës.¹ Në tre muajt e parë, pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Uashingtonit, në Kosovë është bërë një vlerësim i rreth 6 lokacioneve, gjatë të cilit janë gjetur dhe zhvarrosur mbetjet mortore të nëntë personave.²

Gjatë vitit 2021, të dyja palët paralajmëronin gërmime të reja. Megjithatë, procesi u ngadalë-

sua pas takimit të parë në dialogun e vazhduar pas nëntë muajsh, në mes të kryeministrit të ri të Kosovës, Albin Kurti dhe presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq. Kryeministri i Kosovës erdhi më 15 qershor 2021, me katër kërkesa në dialog, e njëra prej tyre ishte shkarkimi i kryetarit të Komisionit për Persona të Zhdukur të Qeverisë së Serbisë, Veljko Odaloviq.³

Megjithatë, në takimet e radhës është diskutuar edhe për personat e zhdukur. Kështu, në shtator, shefi i delegacionit të Prishtinës njoftoi se ishte arritur një marrëveshje për hapjen e arkivave, por deri më sot nuk janë bërë të ditura më shumë detaje rreth kësaj "marrëveshjeje".

Derisa në informacionet lidhur me këtë temë më së shumti flitet për numrin aktual të personave zhdukur dhe deklaratat e akuzat e ndërsjella të negociatorëve, kush është fajtorë për zvarritjen e zgjidhjes së kësaj çështjeje, anashkalohen lëshimet e bëra gjatë dy dekadave të fundit. Prandaj, deklaratat si "nuk do të arrihet marrëveshje përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë derisa nuk gjendet personi i fundit i zhdukur në Kosovë" paraqesin mashtrim për opinionin, sepse këto lëshime kanë bërë që edhe po të ekzistonte vullneti politik i të dyja palëve që në tërësi ta zgjidhin këtë çështje, fati i një numri të caktuar njerëzish, sipas të gjitha gjasave, nuk do të zbardhet kurrë.

1 RSE, Qeveria e Kosovës: "Në varrezën masive në Kizhevak janë zhvarrosur së paku nëntë mbetje mortore", 26 maj 2021. <https://www.slobodnaevropa.org/a/kizevak-ekshumacija/31274412.html>

2 KoSSev, Gara: Mbetjet mortore të nëntë personave janë gjetur për 3 muaj në Kosovë, gërmimet janë kryer edhe në Mitrovicë të K. 19 nëntor 2020. <https://kossev.info/gara-posmrt-ni-ostaci-devet-osoba-pronadjeni-za-3-meseca-na-kosovu-is-kopavanja-vrsena-i-u-k-mitrovici/>

3 KoSSev, Kurti i ka propozuar Vuçiqit Këshillin Kombëtar për Serbët në vend të ASK, kërkon shkarkimin e Odaloviqit dhe njohjen e Kosovës, ka filluar përgatitja e padisë për gjenocid, 15 qershor 2021: <https://kossev.info/kurti-predlozio-vucicu-nacionalno-vece-za-srbe-umesto-zso-trazi-smenu-odalovica-i-priznanje-kosova/>

2. Të dhënat statistikore

Gjatë konfliktit në Kosovë, sipas të dhënave të Fondit për të Drejtën Humanitare janë vrarë 13.518 njerëz. Prej tyre 10.794 Shqiptarë, 2.197 Serbë dhe 527 pjesëtarë të grupeve të tjera etnike që jetojnë në Kosovë. Shumica e tyre është vrarë gjatë vitit 1999. (11.199 njerëz). 11.661 i të vrarëve janë meshkuj, ndërsa 1.857 janë gra.⁴

Pas tërheqjes së forcave serbe nga Kosova, në periudhën 15 qershor 1999 deri në fund të vitit 2000, në Kosovë janë vrarë, kidnapuar apo zhdukur 1.257 njerëz: 717 Serbë, 307 Shqiptarë dhe 233 Romë.

Nga 1.696 zhdukje të evidentuara midis viteve 1998 dhe 2000, 1.129 ishin Shqiptarë, 417 Serbë, 44 Romë, 31 Malazezë, 24 Ashkali, 23 Boshnjakë, 15 Egjiptianë, 3 Maqedonas, 4 Turq, 1 Goran, 1 Hungarez, 1 Jugosllaven, 1 Kroat, 1 Slloven.

Pas 15 qershorit 1999 janë regjistruar 364 zhdukje – 240 Serbë, 45 Shqiptarë, 23 Romë, 20 Malazezë, 14 Boshnjakë, 11 Egjiptianë, 4 Ashkali, 3 Maqedonas, 1 Kroat, 1 Turk, 1 Goran.

1563 persona të zhdukur në databazën e Fondit për të Drejtën Humanitare janë civilë, ndërsa 133 pjesëtar të formacioneve ushtarake.

Komisioni Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur (KNPZH) vlerëson se numri i përgjithshëm i personave të zhdukur gjatë konfliktit në Kosovë është rreth 4.500.

⁴ Baza e të dhënave të FDH

Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (KNKK) ishte ndër organizatat e para që mblodhi të dhëna për personat e zhdukur në konfliktin e Kosovës. KNKK filloi të përpilojë një listë të personave të zhdukur në Kosovë në janar 1998, bazuar, ndër të tjera, në kërkesat e personave që raportuan zhdukjen e anëtarëve të familjeve të tyre. Pas konfliktit të viteve 1998-1999, në këtë listë ishin 6049 emra. Nga këta, 1,372 njerëz u gjetën më pas të gjallë.⁵

Deri më 31 dhjetor 2016, ICMP kishte mbledhur 14,810 mostra referente nga anëtarët e familjes që raportuan të afërmit e zhdukur në ICMP. Këto mostra referente përfaqësojnë 4,415 persona të zhdukur.⁶

Institucione të shumta ndërkombëtare kanë qenë përgjegjëse për gjurmimin e varrezave sekrete dhe gjetjen e mbetjeve mortore në Kosovë.

Në periudhën nga qershori 1999 deri në dhjetor 2016, janë kryer rreth 1.513 operacione (gërmime) në terren, të cilat kanë rezultuar në grumbullimin e 6.097 sete të mbetjeve mortore (të plota dhe jo të plota). 65 për qind e të gjitha mbetjeve mortore u gjetën ndërmjet viteve 1999 dhe 2000 nga ekipet mjeko-ligjore nga Gjykata Penale

⁵ Komisioni ndërkombëtar për persona të zhdukur, Pasqyra e gjendjes, 2017, faqe 29 <https://www.icmp.int/wp-content/uploads/2017/05/koso-vo-stocktaking-report-2017-bcs-2.pdf>

⁶ Komisioni ndërkombëtar për persona të zhdukur, Pasqyra e gjendjes, 2017, faqe 29 <https://www.icmp.int/wp-content/uploads/2017/05/koso-vo-stocktaking-report-2017-bcs-2.pdf>

Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë (ICTY), kur reth 2000 identifikime u bënë bazuar në meto-
da joshkencore dhe klasike të njohjes vizuale.

Sipas të dhënave të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq numri i personave të zhdukur në vitin 2016 ishte 1.666.⁷⁸

Sipas të dhënave të misionit të EULEX-it në Kosovë, në periudhën prej 2016 deri 2020 janë kryer 59 vlerësime në terren, 41 zhvarrosje, janë gjetur mbetjet mortore të 66 personave, ndërsa janë identifikuar 32 persona të zhdukur.⁹

Gjatë vitit 2021, sipas të dhënave të Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, në Kosovë janë zhvilluar gërmimet në 9 lokacione, me çrast janë zhvarrosur dy trupa, ndërsa familjarëve ju kanë dorëzuar mbetjet mortore të 25 personave (5 nga komuniteti serb).¹⁰

Sot, numri i personave të zhdukur, në bazë të evidencës së KNKK është 1.619.¹¹

Numri i mbetjeve mortore të zhvarrosur nga varrezat sekrete është në rënie të konsiderueshme nga viti 2005, ndërsa 15 vite më vonë është shënuar përparim i vogël në procesin e gjetjes së të zhdukurve.¹²

7 Komiteti ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, komunikatë 25. mars 2016. <https://www.icrc.org/en/document/western-balkans-deep-concern-over-numbers-people-still-missing-kosovo>

8 Në atë periudhë në bazën e të dhënave të ICMP gjendeshin 1.876 raste aktive të personave të zhdukur, të cilët nuk përputheshin me të dhënat referente gjenetike me anëtarët e familjeve të të zhdukurve KNPZH, Pasqyrë e gjendjes 2017 qf. 7: <https://www.icmp.int/wp-content/uploads/2017/05/koso-vo-stocktaking-report-2017-bcs-2.pdf>

9 NSI, Efikasiteti i mekanizmave të institucioneve të Serbisë dhe Kosovës për gjetjen e personave të zhdukur gjatë luftës në Kosovë në periudhën prej 2016, deri 2020, prill 2021: <http://newsocialinitiative.org/wp-content/uploads/2021/04/Efikas-nost-mehanizama-institucija-Srbije-i-Kosova-u-pronalazen-ju-nestalih-osoba-iz-rata-na-Kosovu-1.pdf>

10 Qeveria e Kosovës, "Kryeministri Kurti: Nuk ka marrëveshje me Serbinë pa zgjidhjen e çështjes së personave të zhdukur", 10.12.2021, <https://kryeministri.rks-gov.net/sr/premier-kurti-nema-sporazu-ma-sa-srbijom-bez-resavanja-pitanja-nasilno-nestalih-lica/> <https://kosovapress.com/sr/nestale-osobe-kosovo-trazi-odgov-ore-za-pokretanje-iskopavanja-na-novim-lokacijama-u-srbiji/>

11 Radio Kim, Të ndërpritet politizimi me persona të zhdukur, prill 2022, <https://www.radiokim.net/vesti/ratni-zlocini/presta-ti-sa-politizacijom-nestalih-lica.html>

12 Komiteti Ndërkombëtar për persona të zhdukur, Pasqyrë e gjendjes 2017, fq. 14 <https://www.icmp.int/wp-content/uploads/2017/05/koso-vo-stocktaking-report-2017-bcs-2.pdf>

2016

Deri më 31 dhjetor 2016, ICMP kishte mbledhur

14,810

mostra referente

nga anëtarët e familjeve që raportuan të afërmit e zhdukur në ICMP. Këto mostra referente përfaqësojnë

4,415

persona të zhdukur.

1999

Në periudhën nga qershori 1999 deri në dhjetor 2016, janë kryer rreth

2016

1.513

operacione (gërmime) në terren, të cilat kanë rezultuar në grumbullimin e **6.097 sete të mbetjeve mortore** (të plota dhe jo të plota).

65%

e të gjitha mbetjeve mortore u gjetën ndërmjet viteve

1999 dhe 2000 nga ekipet mjeko-ligjore nga Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë (ICTY), kur rreth 2000 identifikime u bënë bazuar në metoda joshkencore dhe klasike të njohjes vizuale.

Gjatë konfliktit në Kosovë,
sipas të dhënave të Fondit
për të Drejtën Humanitare
janë vrarë



Shumica e tyre është
vrrarë gjatë vitit 1999.

11,199
njerëz

13,518 njerëz



10,794
Shqiptarë

2.197
Serbë

527
pjesëtarë të
grupeve të
tjera etnike
që jetojnë në
Kosovë



BURRA

11.661



GRA

1.857

1998

2000

Nga 1,696 zhdukje
të evidentuara midis
viteve 1998 dhe 2000

1,696 zhdukje të evidentuara



1,129
Shqiptarë

417
Serbë

149
pjesëtarë të
grupeve të
tjera etnike
që jetojnë
në Kosovë.

1999

2000

Pas tërheqjes së
forcave serbe nga
Kosova, në periudhën
15 qershor 1999 deri
në fund të vitit 2000,
në Kosovë janë
vrrarë, kidnapuar apo
zhdukur

1,257 njerëz



717
Serbë

307
Shqiptarë

233
Romë

3. Pengesat në zgjidhjen e çështjes së personave të zhdukur në Kosovë

Identifikimi i gabuar, trupat e panjohur në morgun e Prishtinës dhe mostrat referente që nuk përputhen me KNPZH

Që nga përfundimi i konfliktit në Kosovë, detyrën për gjetjen, zhvarrosjen dhe identifikimin e personave të zhdukur, si dhe hetimin dhe ndjekjen penale të personave përgjegjës, e kanë udhëhequr kryesisht nga organizatat ndërkombëtare.

Fillimisht, puna ishte në duart e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ), i cili funksionoi nga viti 1999 deri në vitin 2000, ndërsa përgjegjësia kryesore teknike ishte e Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), ndërsa pas vitit 2008 Misionit për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX). Që nga viti 2014, ka filluar transferimi i kompetencave të EULEX-it tek autoritetet vendore të Kosovës, dhe kjo çështje është plotësisht në kompetencë të institucioneve vendore të Kosovës që nga viti 2018.

Deri në vitin 2002, kur filloi testimi i ADN-së, rreth 2000 raste të personave të zhdukur ishin zgjidhur bazuar në metodat klasike të identifikimit, duke përfshirë identifikimin vizual të para vitit 2002.¹³

¹³ Ibid, qf. 7

Kjo metodë klasike rrit rrezikun e gabimit dhe një numër i madh i rasteve të paidentifikuara nuk është i pazakontë kur personat e zhdukur identifikohen në këtë mënyrë.

Bazuar në analizën e ADN-së të 77 rasteve të kryera në rajonin e Mitrovicës në vitin 2010, të përfunduara më parë në bazë të metodave klasike të identifikimit, KNPZH vlerëson se shkalla e identifikimit të gabuar në rastet e zgjidhura fillimisht pa testim të ADN-së, mund të jetë së paku 17 përqind.¹⁴

Rezultatet treguan se 13 nga 77 identifikime ishin të pasakta. Bazuar në këtë, vlerësohet se numri i identifikimit të pasaktë mund të jetë së paku për 340 raste.

Është e mundur që gabimet e identifikimeve në Kosovë, që kanë ndodhur para fillimit të aplikimit sistematik të analizës së ADN-së, kontribuojnë në dallime të konsiderueshme ndërmjet numrit të personave të evidentuar ende si të zhdukur, numrit të grupeve të referencës së mostrave të gjakut dhe numrit të profileve të ADN-së për të cilat nuk është gjetur ende përputhje.

¹⁴ Ibid, fq. 34



Deri në vitin 2002, kur filloi testimi i ADN-së, rreth 2000 raste të personave të zhdukur ishin zgjidhur bazuar në metodat klasike të identifikimit, duke përfshirë identifikimin vizual të para vitit 2002.

Kjo metodë klasike rrit rrezikun e gabimit dhe një numër i madh i rasteve të paidentifikuara nuk është i pazakontë kur personat e zhdukur identifikohen në këtë mënyrë.

Është gjithashtu e mundur që për disa grupe të mostrave referuese të anëtarëve të familjeve të personave të zhdukur të raportuar, kurrë nuk është gjetur përputhje, që ka rezultuar me atë që trupi i të zhdukurit është kthyer gabimisht në një familje tjetër.

Nga ana tjetër, është e mundur që familja, që ka marrë trupin e gabuar nuk ka dhënë mostra referencë, duke supozuar se kërkimi i tyre për anëtarin e humbur të familjes ka përfunduar, gjë që ka bërë që të mos gjendet asnjë përputhje me mbetjet e zhvarrosura të anëtarit të familjes.¹⁵

Një raport i vitit 2010 vë në pah një element të rëndësishëm në rezultate në numrin e përputhjeve ndërmjet mostrave të zhvarrosura në Kosovë dhe atyre të zhvarrosura nga varrezat masive në Serbi; të gjithë trupat e gjetur në Serbi janë identifikuar përmes analizës së ADN-së dhe jo përmes metodave klasike.¹⁶

Përqindja e profileve përputhëse të gjetura për mbetjet mortore të zhvarrosura në Serbi ishte 97.2%, ndërsa përqindja e përputhjeve për profilet

e mbetjeve të zhvarrosura në Kosovë ishte gjithsej 68.9%.¹⁷

Theksohet se arsyet që kanë çuar në këtë dallim janë të paqarta, por se ekziston mundësia që personat e zhvarrosur në Serbi të jenë persona, zhdukja e të cilëve është rezultat i zhdukjeve me forcë gjatë konfliktit, ndërsa mbetjet e zhvarrosura në Kosovë mund të përfshijnë edhe raste që nuk kanë të bëjnë me konfliktin.

Vlerësohet se ky dallim mund të sqarohet vetëm me një vlerësim sistematik të identifikimeve të gabuara të të theksuara më parë, që kanë ndodhur në fillim të procesit dhe përmes një shqyrtimi të plotë gjithëpërfshirës të origjinës së mostrave të zhvarrosura në Kosovë dhe mënyrës se si janë mbyllur rastet.

KNPZH në raportin e tij gjithëpërfshirës të vitit 2017, thekson se ata kanë 700 profile të ADN-së të marra nga mostrat pas vdekjes, të cilat nuk përputhen me mostrat referente gjenetike, të ofruara nga familjet që janë ende në kërkim të

¹⁵ Komisioni Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur, Pasqyrë e gjendjes 2010, fq. 15
<https://www.icmp.int/wp-content/uploads/2014/08/icmp-dg-264-4-bos-doc-general.pdf>

¹⁶ Ibid, fq. 15

¹⁷ Nga 840 trupa të gjetur në Serbi, u gjend përputhja e profilin me ADN me profilet referente në 817 raste, ndërsa në Kosovë prej 2517 trupa të gjetur në 1487 raste është gjetur përputhja.
Ibid, fq. 20

të afërmve të tyre të zhdukur. Ata shprehen se ka shumë gjasa që kjo situatë të jetë rezultat i rreth 2000 identifikimeve të bëra me metodën e njohjes vizuale në periudhën 1999-2002.

Në morgun e Prishtinës gjenden më shumë se 300 sete të mbetjeve mortore, për të cilat deri më tani janë ezauruar të gjitha mundësitë forenzike të identifikimit. Këto 300 sete të mbetjeve mortore nuk përputhen me asnjë nga 700 ADN profilet e pa-përputhura të KNPZH-së.

Në vitin 2010, stafi mjeko-ligjor i EULEX-it filloi ekzaminimin e mbetjeve mortore të paidentifikuara në morgun e Prishtinës. Në raportin vjetor të vitit 2012, ishte konstatuar se në morgun e Prishtinës kishte 342 raste NN, prej të cilëve 94 do të mund të identifikoheshin në të ardhmen, ndërsa identifikimi nuk është i mundur për 248 të tjerë.¹⁸

Në gusht të vitit 2020, zëvendësdrojtresha e Institutit të Mjekësisë Ligjore të Kosovës dhe eksperte e EULEX-it, Tarja Formisto, vlerësoi se analiza e ADN-së mund të identifikonte deri në 20 persona të zhdukur nëse familjet e të gjithë personave të zhdukur do të jepnin mostra gjaku.¹⁹

Në mars 2022, KNPZH njoftoi se do të ndihmonte Institutin e Mjekësisë Ligjore të Kosovës dhe Komisionin e Qeverisë së Kosovës për Persona të Zhdukur në kryerjen e një analize të re gjithëpërfshirëse për mbi 300 rasteve të mbetjeve mortore të paidentifikuara në morgun e Prishtinës, e cila mund të zgjidhte një numër rastesh.²⁰

¹⁸ Pasqyra e rasteve të NN në morgun e Prishtinës ka rezultuar me dorëzimin e një numri të madh të profileve postmortum në KNPZH për testim të ADN-së, kështu që 45 raste të personave të zhdukur janë zgjidhur në bazë të analizës së ADN-së nga KNPZH.

Komisioni Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur, Pasqyra e gjendjes 2017, fq. 33-34
<https://www.icmp.int/wp-content/uploads/2017/05/kosovo-stocktaking-report-2017-bcs-2.pdf>

¹⁹ EULEX, <https://www.eulex-kosovo.eu/?page=2101241&sqr=missing>

²⁰ Komisioni Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur, <https://www.icmp.int/press-releases/icmp-and-kosovo-authorities-agree-on-the-steps-to-review-the-unidentified-human-remains-in-pristina-mortuary/>
EULEX, saopštenje, 27. april 2022. <https://kossev.info/eulex-pre-gled-posmrtnih-ostataka-u-mrtvacnici-u-pristini-put-napred/>



Një raport i vitit 2010 vë në pah një element të rëndësishëm në rezultate në numrin e përputhjeve ndërmjet mostrave të zhvarrosura në Kosovë dhe atyre të zhvarrosura nga varrezat masive në Serbi; të gjithë trupat e gjetur në Serbi janë identifikuar përmes analizës së ADN-së dhe jo përmes metodave klasike.



Përqindja e profileve përputhëse të gjetura për mbetjet mortore të zhvarrosura në Serbi ishte **97.2%**, ndërsa përqindja e përputhjeve për profilet e mbetjeve të zhvarrosura në Kosovë ishte gjithsej **68.9%**.

4. Hetimet joefikase dhe ndjekja penale për zhdukjet me forcë në Kosovë

Përveç gjetjes, zhvarrimit dhe identifikimit, organizatat ndërkombëtare kanë kryer hetime dhe ndjekje penale për zhdukjet me forcë në Kosovë.

Menjëherë pas përfundimit të konfliktit, raportet për personat e zhdukur nuk u hetuan menjëherë, në mënyrë të paanshme dhe efikase nga policia e UNMIK-ut, dhe të afërmit rrallë ishin informuar për ndonjë përparim në hetime të tilla. Në disa raste, hetimet nuk u zhvilluan kurrë ose hetimi u pezullua pasi mbetjet mortore e personave të zhdukur iu kthyen familjeve të tyre.²¹

Ndonëse kjo lidhet kryesisht me rrëmbimin e serbëve të Kosovës nga pjesëtarët e UÇK-së, dëshime të ngjashme janë vërejtur nga UNMIK-u për të kryer një hetim në kohë, të paanshëm dhe efektiv lidhur me zhdukjet me forcë të shqiptarëve të Kosovës nga policia serbe, ushtria dhe njësitë paraushtarake.

Përgjegjësitë e UNMIK-ut në këtë drejtim janë marrë nga EULEX-i që nga viti 2009, për të cilin Amnesty International vlerëson se ka bërë « përparim të caktuar » në hetimin e zhdukjeve me

forcë deri në vitin 2013 në zhdukjen e shqiptarëve të Kosovës nga forcat serbe. Në anën tjetër, "pak progres" është bërë në hetimet dhe ndjekjet penale për rrëmbimet e serbëve dhe pakicave të tjera.²²

Nga viti 2014, EULEX-i filloi transferimin e kompetencave tek institucionet e Kosovës dhe nga viti 2018 kjo çështje ka kaluar plotësisht në juridiksionin e tyre.

Që nga qershori 2018, Prokuroria Speciale e Kosovës ka juridiksion ekskluziv për të hetuar dhe ndjekur penalisht krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të drejtës ndërkombëtare humanitare.

Në "Strategjinë për Krimet e Luftës 2019" e Këshillit Prokurorial të Kosovës thuhet se i ka dorëzuar EULEX STK-së rreth 900 lëndë për krime lufte dhe shkelje të tjera të së drejtës ndërkombëtare humanitare, si dhe rreth 2000 raste që kanë të bëjnë me rrëmbimin apo zhdukjen e personave gjatë dhe pas konfliktit të armatosur në Kosovë.²³

21 Kosovo: UNMIK's legacy: The failure to deliver justice and reparation to the relatives of the abducted, Amnesty International, 2013, str. 5: <https://www.amnesty.org/download/Documents/16000/eur700092013en.pdf>

22 Ibid, fq. 8 : <https://www.amnesty.org/download/Documents/16000/eur700092013en.pdf>

23 Strategjia e krimeve të luftës, Këshilli Prokurorial I Kosovës, Prokuroria e Shtetit, Prishtinë, shkurt 2019, qf. 5: <https://prokurorjarks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/KPK/Dokumente%20Strategjike/STRATEGJIA%20RATNIH%20>

Strategjia thekson se "nga dorëzim-pranimi i EULEX-it është e qartë se rastet e personave të zhdukur nuk janë proceduar dhe se EULEX-i nuk u ka dhënë atyre prioritet gjatë mandatit të tij", si dhe atyre nuk u është dhënë asnjë shpjegim se pse.²⁴

Duke pasur parasysh numrin e rasteve të transferuara në prokurori dhe polici nga EULEX-i, strategjia thekson se "është joreale të pritët që të gjitha shkeljet e supozuara të së drejtës ndërkombëtare humanitare, të kryera gjatë ose pas konfliktit të hetohen ose të procedohen në të njëjtën mënyrë dhe me të njëjtin përkushtim, veçanërisht duke pasur parasysh burimet e kufizuara të ndara për Prokurorinë Speciale dhe Sektorin e Personave të Zhdukur të Policisë së Kosovës".²⁵

Një nga problemet kryesore kur bëhet fjalë për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të luftës, përfshirë edhe fatin e të pagjeturve, u theksua mungesa e një plani strategjik apo marrëveshjeje në mes të Kosovës dhe Serbisë. Në strategji theksohet se bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit ndërmjet prokurorive të Kosovës dhe Serbisë pothuajse nuk ekziston dhe se "protokolli i vetëm ekzistues mbi bashkëpunimin është ai ndërmjet policisë së EULEX-it dhe Ministrisë së Brendshme të Serbisë". Problem të veçantë paraqet imuniteti i të dyshuarve, që gjenden në Serbi apo vende të tjera në territorin e ish-Jugosllavisë, si dhe materiali dëshmues i cili "shpesh gjendet në Tribunalin e Hagës dhe organizata të tjera ndërkombëtare".²⁶

Sipas të dhënave të FDH në Kosovë, nga viti 1999 deri në fund të vitit 2020, në Kosovë janë dënuar për krime lufte 41 persona (34 shqiptarë, 6 serbë dhe 1 rom). Në më shumë se 90% të këtyre rasteve janë shqiptuar dënime për krime të kryera kundër popullatës civile shqiptare.²⁷

Një nga problemet kryesore kur bëhet fjalë për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të luftës, përfshirë edhe fatin e të pagjeturve, u theksua mungesa e një plani strategjik apo marrëveshjeje në mes të Kosovës dhe Serbisë. Në strategji theksohet se bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit ndërmjet prokurorive të Kosovës dhe Serbisë pothuajse nuk ekziston dhe se "protokolli i vetëm ekzistues mbi bashkëpunimin është ai ndërmjet policisë së EULEX-it dhe Ministrisë së Brendshme të Serbisë".

Për shkak të dyshimeve të bazuara apo akuzave se kanë kryer krime lufte kundër civilëve, në vitin 2021 janë iniciuar apo zhvilluar procedura penale në faza të ndryshme pranë gjykatave të Kosovës në njëmbëdhjetë (11) raste kundër tetë (8) serbëve dhe tre (3) shqiptarëve.²⁸

Dy aktakuzat e para për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit para Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë (Gjykata Speciale), janë ngritur dhe konfirmuar në vitin 2020, dhe në njërin prej tyre të akuzuarit, ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veselji, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi, përveç tjerash, akuzohen edhe për zhdukje me forcë.

ZLOCINA.pdf

²⁴ Ibid, fq. 10

²⁵ Ibid, fq. 10

²⁶ Ibid, fq. 18-19, 6

²⁷ NSI, Efikasiteti i mekanizmeve të institucioneve të Serbisë

dhe Kosovës në periudhë prej 2016 deri 2020, prill 2021, fq. 21 <http://newsocialinitiative.org/wp-content/uploads/2021/04/Efikasnost-mehanizama-institucija-Srbije-i-Kosova-u-pronala-zenju-nestalih-osoba-iz-rata-na-Kosovu-1.pdf>

²⁸ FHP Kosovë, Raporti për vitin 2021. <https://www.hlc-kosovo.org/storage/app/media/Kosovo%20report%202021%20ALB%20SRB%20ENG.pdf>

5. Arkivat (Jo)ekzistuese

Hapja e arkivave konsiderohet si një nga mjetet e rëndësishme për zgjidhjen e ngërçit në gjetjen e personave të zhdukur nga konflikti i Kosovës.

Deri më 10 qershor 1999, kur UNMIK-u mori përgjegjësinë për qeverisjen e Kosovës, Ministria e Brendshme e Serbisë ishte i vetmi institucion tek i cili shqiptarët e Kosovës mund t'i raportnin zhdukjet me forcë.

Në vitet menjëherë pas konfliktit, ka ekzistuar një konfuzion i madh për numrin dhe identitetin e personave të zhdukur. Përveç KNKK-së, raportimet për personat e zhdukur janë pranuar dhe kërkuar në mënyrë aktive nga Zyra e UNMIK-ut për të Burgosur dhe Persona të Zhdukur, Komisioni për Kërkimin dhe Identifikimin e Viktimave (VRIC) i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), dhe disa OJQ ndërkombëtare dhe vendore, si dhe shoqata të familjeve të personave të zhdukur dhe të rrëmbyer.

Një numër i madh agjencish dhe paqartësish se kush duhet të raportojë zhdukjen e personave kanë çuar në një vonesë të madhe në përcaktimin e numrit dhe identitetit të të zhdukurve dhe, si pasojë, ka shkaktuar vonesë në hapjen e hetimeve penale.

Rëndësia e hapjes së arkivave ndërkombëtare për të zbardhur fatin e të zhdukurve në Kosovë buron nga numri i madh i organizatave të ndryshme ndërkombëtare që janë marrë me këtë çështje.

Pikërisht për shkak të një numri të madh të organizatave të ndryshme ndërkombëtare, që merreshin me këtë çështje qëndron rëndësia e hapjes së arkivave ndërkombëtare, me qëllim të zbardhjes së fatit të personave të zhdukur në Kosovë.

Për më tepër, hapja e arkivave të Beogradit dhe Prishtinës konsiderohet vendimtare për zgjidhjen e kësaj çështjeje. Deri më tani, Beogradi hapjen e arkivave e ka kushtëzuar me reciprocitet, pra me gjetjen dhe hapjen e arkivave të UÇK-së. Në anën tjetër, Prishtina në vazhdimësi e ka mohuar ekzistencën e tyre, duke pretenduar se UÇK-ja ka qenë organizatë guerile dhe se arkivat ushtarake nuk ekzistojnë.

Në shtator të vitit 2021, shefi i delegacionit të Prishtinës njoftoi se në Bruksel u arrit dakordimi për hapjen e arkivave.²⁹ Mirëpo, njoftimi fillestar nuk është realizuar ndërkohë dhe as nuk është mësuar më shumë për këtë marrëveshje, përveç deklaratës fillestare të negociatorëve.

29 Besnik Bislimi, negociatori kryesor i Kosovës: „Në një moment, zotëri Petković u pajtua se duhet të kemi qasje të plotë në të gjitha arkivat, duke përfshirë arkivat ushtarake në Beograd, si dhe qasje në arkivin e UÇK-së. Nuk ekzistojnë arkivat e UÇK-së, por ekzistojnë arkivat shtetërore për UÇK në Kosovë dhe ne jemi të hapur për shkëmbimin e këtyre informatave”, KoSSev, 8. Shtator 2021. <https://kossev.info/bislimi-iz-brisela-dogovoreno-otvaranje-arhiva-nema-uslova-za-sastanak-vucic-kurti/>

6. Mangësitë dhe dispozitat diskriminuuese në kornizën juridike të Kosovës për zgjidhjen e çështjes së të zhdukurve

Korniza juridike në fuqi në Kosovë rregullon pozitën dhe të drejtat e personave të zhdukur dhe familjeve të tyre me një sërë ligjesh,³⁰ por ekzistojnë edhe probleme.

Korniza juridike që rregullon këtë çështje nuk i plotëson në tërësi nevojat e familjarëve të personave të zhdukur. Për më tepër, disa dispozita ligjore kanë prodhuar trajtim të pabarabartë, si për personat e zhdukur ashtu edhe për anëtarët e familjeve të tyre, veçanërisht kur bëhet fjalë për përfitime sociale, që ndryshojnë nga kategoritë e tjera të viktimave të luftës në Kosovë.

30 Ligji për personat e zhdukur, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2765>

Rregullorja nr. 15/2012 për Punën e Komisionit për personat e zhdukur, RREGULLORE NR. 15/2012 PËR PUNËN E KOMISIONIT QEVERITAR PËR PERSONA TË ZHDUKUR (rks-gov.net)

Ligji nr. 05/L-060, për mjekësinë ligjore, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=12325>

Ligjin për Statusin dhe të Drejtat Dëshmorëve, Invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës, viktimave civile dhe familjeve të tyre, u <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2793>

Ligji nr. 04/L-131 për skemat e pensioneve të financuar nga shteti <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9517>

Një formë shtesë e diskriminimit është e pranishme në lidhje me personat e zhdukur dhe anëtarët e familjeve të tyre që u zhdukën pas 20 qershorit 1999. Konkretisht, në momentin kur gjenden mbetjet mortore të atij personi, ai pushon së cilësuar si person i zhdukur, por viktimë civile e luftës. Megjithatë, perioda kohore për të cilën një person i vrarë në konfliktin e Kosovës konsiderohet viktimë civile është i kufizuar në 20 qershor 1999, që do të thotë se familjet e personave të zhdukur nuk kanë të drejtë në përfitime sociale që nga momenti i gjetjes së anëtarit të familjes së tyre të zhdukur nëse ai zhduket pas kësaj date, sepse korniza ligjore e Kosovës nuk e njeh atë të drejtë.

Kjo dispozitë përfshin veçanërisht pjesëtarët e komuniteteve joshumicë në Kosovë, duke pasur parasysh se ata përbëjnë shumicën e të zhdukurve pas 20 qershorit 1999.

Koncepti i dokumentit për personat e zhdukur i Qeverisë së Kosovës nga viti 2019 vlerësoi si diskriminues përcaktimin e pensionit që gëzojnë



Koncepti i dokumentit për personat e zhdukur i Qeverisë së Kosovës nga viti 2019 vlerësoi si diskriminues përcaktimin e pensionit që gëzojnë familjarët e personave të pagjetur dhe përqindjen në raport me numrin e personave të zhdukur në një familje, duke qenë se legjislacioni aktual ndan në përqindje shumë e pensionit familjar kur në familje janë dy ose më shumë persona të zhdukur.

familjarët e personave të pagjetur dhe përqindjen në raport me numrin e personave të zhdukur në një familje, duke qenë se legjislacioni aktual ndan në përqindje shumë e pensionit familjar kur në familje janë dy ose më shumë persona të zhdukur.³¹

Gjithashtu, trajtimi i pabarabartë është vendosur me kategoritë tjera të përshkruara në Ligjin për Statusin dhe të Drejtat Dëshmorëve, Invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës, viktimave civile dhe familjeve të tyre, për mbështetje institucionale, kujdesi shëndetësor dhe lehtësira të tjera në shërbimet publike.

Për më tepër, ai detyron anëtarët e familjes të vendosnin midis një pensioni individual/kontribut dhënës dhe një pensioni familjar për kategoritë e dala nga lufta.

Korniza juridike në fuqi vetëm pjesërisht trajton çështjen e sendeve dhe veshmbathjes të personave të zhdukur, si dhe mënyrën e mem-

orizimit të lokacionit/varrezave në të cilat janë gjetur trupat e personave të zhdukur.

Mungesa e akteve nënligjore ka pamundësuar zbatimin në praktikë të disa dispozitave ligjore të Ligjit për Personat e Zhdukur dhe kështu nuk është përmbushur obligimi i paraparë me këtë ligj. Madje, mungesa e këtyre akteve ka shkaktuar probleme serioze për familjarët e personave të zhdukur, të cilët në disa raste nuk i kanë realizuar të drejtat e tyre sipas ligjit në fuqi.³²

Në mesin e vitit 2021, Qeveria e sapoformuar e Kosovës njoftoi se ka filluar procedura për ndryshimin e Ligjit për Personat e Zhdukur dhe se deri në fund të vitit do të jetë në Kuvend, gjë që ende nuk ka ndodhur.³³

31 Koncept dokument i Qeverisë së Kosovës, 25.04.2019, <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?Consultation-ID=40640>

32 Koncept dokumenti Qeverisë së Kosovës, 25.04.2019, <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?Consultation-ID=40640>

33 Kabineti kryeministrit të Kosovës, 29.08.2021, <https://kryeministri.rks-gov.net/sr/premijer-kurti-sastao-se-sa-predsednistvom-koordinacionog-saveta-udruzenja-clanova-porodica-nestalih-sa-kosova/>

7. Përvojat e familjeve të personave të kidnapuar dhe të zhdukur nga komuniteti serb në Kosovë³⁴

Të gjitha familjet e personave të zhdukur nga Shtërpsa kanë shfrytëzuar të drejtën e tyre për përfitime sociale. Mirëpo, anëtarët e Shoqatës së Familjeve të Personave të Zhdukur theksojnë se arsye për këtë ka qenë organizimi i mirë dhe bashkëpunimi i tyre me Zyrtarin për persona të zhdukur dhe komunën e Ferizajt. Në momentin që morën vesh se kishin të drejtë për përfitime sociale, njoftuan familjarët e tyre, i ndihmuan në mbledhjen e dokumentacionit të nevojshëm dhe organizuan transportin e tyre. Ata besojnë se gjëja kryesore në këtë rast ka qenë vullneti i mirë dhe hapja për bashkëpunimin e zyrtarëve në Ferizaj.³⁴

Ndërsa Graçanicë, anëtarët e shoqatës theksojnë se jo të gjitha familjet kanë mundur ta realizojnë këtë të drejtë, duke thënë se familjarëve të personave të zhdukur nga komuniteti serb u janë vendosur kushte dhe kërkesa që familjet nuk mund t'i plotësojnë.

“Në Graçanicë të gjitha familjet nuk kanë mundur që ta realizojnë të drejtën e tyre për përfitime sociale. Në një rast, kërkesa u refuzua sepse data e gërmimit, zhvarrosjes dhe varrimit nuk përputhej. Është e kërkuar e pamundura, që normalisht nuk mund të jetë e njëjta datë. Kështu qëndron në vendim.”

Si një ndër probleme më të mëdha në këtë proces theksohet mosrespektimi i drejtës për përdorimin e gjuhës.

„Në fillim kur shkuam të aplikojmë për atë ndihmë, kur u flet serbisht, ata nuk të flasin fare, dhe pastaj bëjmë përpjekje dhe me vështirësi arrijmë të merremi vesh. E njëjta gjë po ndodh dhe sot sepse ne duhet të lajmërohemi çdo gjashtë muaj. Ne kemi gjithmonë të njëjtin problem, duhet të marrim dikë me vete që të na përkthejë, për diçka që duhet të jetë një punë 5 minuta”.

Shumë anëtarëve të familjeve si në Shtërpsë ashtu edhe në Graçanicë u është mohuar pensioni personal i pleqërisë pasi kanë marrë këtë lloj ndihme, e cila gjithashtu u takon për arsye të tjera.

³⁴ Informatat e paraqitura në këtë pjesë janë marrë në bazë të pesë intervistave dhe dy fokus grupe me anëtarët e Shoqatës së Familjeve të personave të kidnapuar dhe të zhdukur nga Graçanica dhe Shtërpsa.



„Në fillim kur shkuam të aplikojmë për atë ndihmë, kur u flet serbisht, ata nuk të flasin fare, dhe pastaj bëjmë përpjekje dhe me vështirësi arrijmë të merremi vesh. E njëjta gjë po ndodh dhe sot sepse ne duhet të lajmërohemi çdo gjashtë muaj. Ne kemi gjithmonë të njëjtin problem, duhet të marrim dikë me vete që të na përkthejë, për diçka që duhet të jetë një punë 5 minuta”.

Ata nuk janë të informuar lidhur me ecurinë e procedurës për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Persona të Zhdukur dhe se çfarë ndryshimesh kërkohen.

Anëtarët e shoqatës nga Shtërpca theksuan se kanë bërë përpjekje që të marrin informata nga përfaqësuesit e Komisionit për Persona të Zhdukur të Qeverisë së Kosovës, në takimet e organizuara nën patronatin e Qendrës Burimore për Persona të Zhdukur, por përkundër premtimit se do t'u dërgohet informacioni, kjo nuk ndodhi.

Ata e cilësojnë punën e institucioneve që merren me personat e zhdukur në Kosovë si pasivitet, ndërsa Qendra Burimore veçohet si e vetmja organizatë nga e cila herë pas here mund të marrin informacione dhe kontakte.

“Në fillim mund të ndiqnim se kush merret me këtë çështje, sot ka kaq shumë organizata, komisione të grupe punuese me të cilat nuk kemi shumë kontakte. “Shumë institucione po bëjnë dhe po marrin diçka mbi kurrizin tonë dhe ata nuk janë këtu për të zgjidhur këto çështje, por për interesin e tyre”.

Katër muaj pas emërimit të kryetarit të ri të Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, Unioni i Shoqatave të Familjeve të Personave të Rrëmbyer dhe të Zhdukur, me seli në Graçanicë, i ka bërë thirrje kryeministrit të Kosovës Albin Kurti që të emërojë një zëvendëskryetar të Komisionit nga radhët e komuniteteve joshumicë. Kjo nuk ka ndodhur ende.³⁵

Anëtarët e Shoqatës së Personave të Zhdukur të Graçanicës janë shprehur të zhgënjyer me kryetarin e ri të Komisionit të Qeverisë së Kosovës për Persona të Zhdukur.

„Me emërimin e tij ne fituam shpresë sepse u emërua një person i cili është edhe anëtar i familjes së një personi të zhdukur. Menduam se do ta shikonte ndryshe zgjidhjen e kësaj çështje, se do të ishte më i interesuar, por jemi të zhgënjyer”.

³⁵ Kossev, *Unioni i shoqatës nga GR: Kurti ta emërojë zëvendësin e kryetarit të Komisionit për persona të zhdukur nga radhët e komuniteteve joshumicë*, 4. Nëntor 2021. <https://kos-sev.info/unija-udruzenja-iz-gr-kurti-da-imenuje-zamenika-pred-sednika-komisije-za-nestale-iz-nevecinske-zajednice/>

Ata shtuan se kanë marrë pjesë edhe në një takim me të, por se më shumë ka qenë "përbushje e kuotës dhe për të treguar se si ka ekuilibër" sesa shprehje e dëshirës reale për t'u takuar me familjet e të pagjeturve nga komuniteti serb.

Ata e cilësojnë si inekzistente punën dhe bashkëpunimin me Policinë dhe Prokurorinë e Kosovës në Shtërpçë, duke theksuar se nuk kanë marrë informacion nga këto institucione për gjendjen e rasteve të tyre dhe as janë kontaktuar prej tyre.

"Sa i përket policisë, sa herë që ka qenë në interes të zbulohet diçka, nuk kanë punuar, me qëllim të fshehjes se serbët janë vrarë, kidnapuar dhe zhdukur, për të qenë të pastër para botës dhe Evropës, sikur të ishin viktima", - Graçanicë.

Në anën tjetër, ata janë edhe të zhgënjyer dhe të pakënaqur me bashkëpunimin me organizatat ndërkombëtare në Kosovë, që janë marrë me çështjen e personave të zhdukur. "Nuk kemi marrë asnjë informacion konkret për fatin e familjarëve tanë, vetëm premtime që do të ketë".

Pritshmërinë më të lartë e kishin në muajt e parë pas raportimit për zhdukjen e familjarëve. Prezenca e pjesëtarëve të KFOR-it dhe policisë së UNMIK-ut, të cilët, siç theksuan ata, i vizitonin dhe mbanin kontakte me ta çdo disa ditë, dhe premtimet se ishin afër dhe se do t'i gjenin familjarët e tyre u dha shpresë. Megjithatë, me ndryshimin e anëtarëve të misioneve ndërkombëtare për disa muaj, me ardhjen e grupeve të reja, i gjithë procesi përsëritej nga e para. Familjarët e të zhdukurve jepnin sërish informacione për të zhdukurit, e kështu me radhë.

Më vonë vjen EULEX-i, i cili premtoi se do të punojë ndryshe në raport me OKB-në, gjë që na dha shpresë. Megjithatë, e njëjta bie ra në ujë. Policia e Kosovës është duke u formuar dhe nuk mund t'i besojmë kur e dimë se aty



Disa anëtarë të shoqatës pretenduan se kishin marrë pjesë në takime, në të cilat disa zyrtarë mohuan ekzistencën e viktimave serbe në konfliktin e Kosovës. Sipas tyre, deri më sot, as në takime të hapura dhe as të mbyllura, nuk ka ndodhur që zyrtarët shqiptarë ta shtrijnë dorën e bashkëpunimit dhe të pranojnë ekzistencën e viktimave serbe.

punojnë edhe personat që kanë marrë pjesë në ato krime. Deri më tani ka ekzistuar njëfarë shprese, por që nga momenti kur EULEX-i ia dorëzoi rastet Policisë së Kosovës, çdo shpresë ka humbur".

"Shumë nga prindërit që vdiqën nuk morën vesh asgjë. Unë jam i mendimit se gjithçka do të vazhdojë pafundësisht, se gjithçka do të bjerë në harresë. Dyshoj qartë se një nga rastet tona do të zgjidhet gjatë jetës sime, sepse ata nuk janë të interesuar për këtë."

Përderisa familjarët nga Shtërpça shprehen pozitivisht për Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq si e vetmja organizatë ndërkombëtare që mban rregullisht kontakte me familjet dhe i viziton ato "duke krijuar përshtypjen se dikush ende po bën diçka», anëtarët e shoqatës së Graçanicës nuk e ndajnë këtë mendim.

"Në fillim organizatat dhe përfaqësuesit ndërkombëtarë e shprehën më pak angazhimin e tyre ndaj palës shqiptare, por më pas nga dita në ditë gjithnjë më shumë. Asnjë institucion tashmë nuk e fsheh këtë. Kur kemi takime me ta, ata flasin për të zhdukurit, nuk i ndajnë serbët dhe shqiptarët, por gjithmonë flasin për lokacione në Serbi dhe jo në Kosovë".

Organizatrat ndërkombëtare si në Shtërpçë ashtu edhe në Graçanicë besojnë se kanë informacionin e nevojshëm për ta zbardhur fatin e familjarëve të tyre, por se nuk ka presion të mjaftueshëm për t'i vënë ata në dispozicion.

Anëtarët e Shoqatës së Familjeve të Personave të Zhdukur nuk kanë pritshmëri të mëdha nga përfshirja formale e temës së personave të pagjetur në dialogun ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës.

“Ne personalisht ishim kundër që të pagjeturit të jenë pjesë e dialogut në Bruksel pikërisht për këto arsye, Kurtit nuk i pëlqen Odaloviqi dhe gjithçka ndalet, dhe nëse kjo çështje nuk do të kishte shkuar në Bruksel, ndoshta do të kishte bërë diçka. Në këtë mënyrë, çështja është bërë shumë e politizuar

Duke marrë parasysh se çështja është gjithsesi pjesë e dialogut, ata theksojnë se skenari ideal që ata të marrin pjesë në dialog do të ishte një palë e tretë – pala familje dhe se kontakti i drejtpërdrejtë me ekipet negociatore, në mënyrë që të ishin të informuar për ngjarjet dhe përparimin në drejtim të zgjidhjes së kësaj çështjeje, pasi informacionet për të marrin vetëm në media.

Retorikën e zyrtarëve kosovar e konsiderojnë vetëm si të njëanshme.

„Problem është ngase ajo (Vjosa Osmani) përmend vetëm viktimat e tyre, ndërsa viktimat serbe kurrë nuk i përmend”.

Disa anëtarë të shoqatës pretenduan se kishin marrë pjesë në takime, në të cilat disa zyrtarë mohuan ekzistencën e viktimave serbe në konfliktin e Kosovës. Sipas tyre, deri më sot, as në takime të hapura dhe as të mbyllura, nuk ka ndodhur që zyrtarët shqiptarë ta shtrijnë dorën e bashkëpunimit dhe të pranojnë ekzistencën e viktimave serbe.

Sa i përket bashkëpunimit me organizata dhe shoqata të tjera të familjeve të të pagjeturve, shoqata nga Shtërpca në Kosovë ka kontak-

te dhe bashkëpunim me shoqatat serbe në Graçanicë, Hoçë të Madhe dhe Mitrovicë, ndërsa në Serbi janë pritur me një qëndrim të ftohtë.

Nga ana tjetër, kur bëhet fjalë për shoqatat shqiptare në Kosovë, ata theksojnë se kontaktet e vetme me ta janë përmes Qendrës Burimore për Persona të Zhdukur.


Po ashtu, përfaqësuesit politikë të Serbëve në Kosovë nuk kanë bërë përpjekje të krijojnë kontakte me familjet e të zhdukurve nga Shtërpca.

„Autoritetet lokale në Shtërpçë janë pajtuar që pa u konsultuar me ne, të vendoset një monument për të vrarët dhe të zhdukurit nga Shtërpca, 2006-2007. Kur duhej të vendosin, na thirrën një ditë më parë sepse kishin nevojë për miratimin tonë. Ne nuk ramë dakord sepse askush nuk na kishte pyetur ndonjëherë nëse ishim mirë, nëse kishim nevojë për ndihmë për të krijuar ndonjë kontakt... Monumenti ka emrat e atyre që vdiqën, por jo edhe të zhdukurve deri më sot”.

Në mesin e familjeve ka edhe raste sociale që jetojnë në varfi të skajshme.

Ata e konsiderojnë përgjegjëse bashkësinë ndërkombëtare dhe veçanërisht KFOR-in, të cilët besojnë se kanë informacione për fatin e të zhdukurve, si përgjegjës kryesor për gjetjen e të zhdukurve.

“KFOR-i ka hyrë i pari, ka lejuar gjithçka, mendoj se ata i kanë të gjitha informatat”.



Në fillim organizatat dhe përfaqësuesit ndërkombëtarë e shprehën më pak angazhimin e tyre ndaj palës shqiptare, por më pas nga dita në ditë gjithnjë më shumë. Asnjë institucion tashmë nuk e fsheh këtë. Kur kemi takime me ta, ata flasin për të zhdukurit, nuk i ndajnë serbët dhe shqiptarët, por gjithmonë flasin për lokacione në Serbi dhe jo në Kosovë”.

Iniciativa Open është e përkrahur nga KFOS

